

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 E enjte, 24 nëntor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi dhe mirë se erdhët.

7 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i
10 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
12 që në të djathtë kemi të njëjtën përbërje, që do të thotë që
13 nga e Prokurorit të Specializuar, Mbrojtësi i Viktimave.

14 Dhe po shoh Mbrojtjen që ka një ndryshim. Z. Gilissen, ju
15 jap fjalën të më thoni kush është i pranishëm.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
17 Gjykatëse. Unë jam Jean-Louis Gilissen. Jemi këtu me z. Shala,
18 që na ndjek nga objekti i paraburgimit. Znj. Melissa McKay,
19 Dzeneta Petrovica, znj. Juliette Healy dhe Judit Kolbe.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit.

22 Mirëmëngjes, z. Shala. A më dëgjoni mirë?

23 I AKUZUARI:[Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Ju dëgjoj
24 mirë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 Shala, më behët qejfi që po na ndiqni me videolidhje sot,
2 Trupi Gjykues mendon se është shumë e rëndësishme që ju të
3 jeni i pranishëm, të ndiqni seancat gjyqësore, qoftë kjo me
4 videolidhje apo fizikisht në sallën e gjyqit. Mbase ju mund të
5 ndërveproni kështu me ekipin e Mbrojtjes. Megjithatë, unë jua
6 lë ju në dorë të konsultoheni me avokatin tuaj për të vendosur
7 sesi doni që ta ndiqni këtë seancë gjyqësore.

8 Tani keni fjalën. Keni fjalën.

9 I AKUZUARI:[Përmes videolidhjes] Ju faleminderit, e
10 nderuar Gjyqtare. Kam nevojë në privat pak. Në qoftë se është
11 më e mundshme, jo për publikun.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
13 na e shpjegoni, në momentin që do të kalojmë në seancë
14 private, do na e shpjegoni dhe pse doni që të jemi në seancë
15 private.

16 Sekretare e Gjykatës, të kalojmë në seancë private.

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Do vazhdojmë me pyetjet nga ana e ZPS-së për dëshmitaren

25 e Mbrojtjes znj. Time Kadriaj.

1 Asistente, ju lutem sillni dëshmitaren në sallë.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
4 se u kthyet, znj. Dëshmitare. A më dëgjoni?

5 DËSHMITARJA: Po. Tash po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
7 Z. Shala, a e dëgjoni dëshmitaren?

8 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, e ndëgjoj shumë
9 mirë. Faleminderit.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
11 Dëshmitare, si jeni sot?

12 DËSHMITARJA: Mirë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
14 Dëshmitare, ju rikujtoj që jeni ende nën betim për të thënë të
15 vërtetën. E kuptoni këtë?

16 DËSHMITARJA: Po.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

18 DËSHMITARJA: W04440 [Vijon]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Prokuror, a e kuptova unë saktë dje, që ju kishit edhe pesë
21 minuta?

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, për afërsisht. Pesë, dhjetë
23 minuta.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
25 atëherë. Keni fjalën.

1 Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis:

2 [Vazhdim]

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

4 PY. Mirëmëngjes, znj. Kadriaaj.

5 PË. Mirëmëngjes.

6 PY. Znj. Kadriaaj, dje unë ju bëra një pyetje - që është e
7 reflektuar në faqen 3607 të transkriptit - ju pyetja a besoni
8 se personat që kanë qenë viktimat të krimeve nga disa anëtarë
9 të UÇK-së kanë të drejtën të gjejnë drejtësi. Dhe u
10 përgjigjët, ju thatë:

11 "Çdo njeri ka të drejtën të kërkojë drejtësi".

12 Ky është qëndrimi jua, apo jo?

13 PË. Jo, veç ata persona, po të gjithë që mendojnë që ju kanë
14 shkelë të drejtat e tyre, në këtë botën demokratike, kanë të
15 drejtë të kërkojnë drejtësi. Është vendim individual i
16 secilit.

17 PY. Ju e miratoni vendimin e një personi që përpiket ta
18 kërkojë këtë drejtësi përpara një gjykate nëse ky person beson
19 se ka qenë viktimë e një krimi?

20 PË. Është e drejtë individuale me kërku drejtësi.

21 PY. A pajtoheni ju që ata ta ushtrojnë këtë të drejtë, e
22 mbështesni? E mbështesni përpjekjen e një individi që kërkon
23 drejtësi nëse ky person vendosë?

24 PË. Është e drejtë, thashë, e tyre me kërku drejtësi dhe s'ka
25 të drejtë askush t'ia mohojë këtë të drejtë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: W04444 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis (Vazhdim)
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

Faqe 6

1 PY. Në rregull. Gjeta një artikull në media ku ka disa
2 deklarata tuajat që janë të datës 3 prill 2023, është
3 pikërisht data kur filloi gjykimi kundër Hashim Thaçi, Rexhep
4 Selimit, Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit në këtë sallë
5 gjyqi.

6 Do të doja të diskutonim këtë artikull për të cilin po
7 flas. Edhe ta kombinojmë me përgjigjet që thatë dje dhe që e
8 thatë po sot sa i takon të drejtës për të kërkuar drejtësi.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, artikullin
10 e kam në të dyja gjuhët, kështu që do preferoja t'i vendosnim
11 përbri. Shqipja është 116107-116107. Me të njëjtin numër është
12 dhe anglishtja po përfundon me -ET.

13 PY. Znj. Kadriaj, ky është një artikull që është shkruar --
14 PË. Kam harruar syzet.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
16 kuptojmë këtë. Asistentja e Gjykatës, mund të shkojë të marrë
17 një palë syze për ju ose ju mund të shkoni me të t'i gjeni
18 syzet. Mirë shkoni, shkoni me Asistenten e Gjykatës që të
19 merrni syzet. Do ju presim.

20 DËSHMITARJA: Faleminderit.

21 [Dëshmitarja përfundon dëshminë]

22 [Dëshmitarja vijon dëshminë]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
24 se erdhët.

25 Prokuror, fjala është sërish për ju.

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

2 PY. Znj. Kadriaj, do të doja të fokusoheshim në paragrafin e
3 katërt, paragrafin që është në fund të faqes.

4 Së pari, a ju kujtohet që e keni dhënë intervistë më 3
5 prill 2023? Pra, e konfirmoni që ia keni dhënë këtë intervistë
6 Lulzimin Gajtanit apo editorialit Dukagjini?

7 PË. Kam dhënë shumë intervista meqë jam figurë publike, jam
8 deputete, jam non-stop e ekspozuar nëpër medime. Po e lexoj
9 këtu, kam shumë, po e shoh.

10 PY. Dëshironi ta lexoni fillimisht dhe më pas të ma thoni
11 nëse është deklarata juaj? Znj. Kadriaj, a është deklarata
12 juaj kjo?

13 PË. Po.

14 PY. Faleminderit. Paragrafi i tretë dhe i katër, sidomos
15 paragrafi i katërt, do të doja të fillonim me të parin thuhet
16 se ju keni thënë se:

17 "... kjo është e padrejtë që të gjykohen ata që kanë bërë
18 luftë të drejtë dhe luftë çlirimtare".

19 Dua të më ndihmoni ta kuptoj çfarë keni dash të thoni ju
20 me këtë? A besoni ju se të bësh luftë të drejtë do të thotë që
21 personat nuk duhet të mbajnë përgjegjësi për krimet që mund të
22 kenë kryer për gjatë luftës që ata kanë luftuar?

23 PË. E keni keqkuptuar. Sepse pa u sjellë një verdikt final
24 nuk mundem me i gjyky askënd. Mendimi im është personal dhe
25 prapë e besoj sepse ka pasë edhe anëtarë të tjerë të UÇK-së që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: W04444 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 8

Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis (Vazhdim)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 janë gjykuar nga kjo gjykatë dhe janë shpallë të pafajshëm.
2 Ndërsa derisa nuk sillet një vendim i Gjykatës, nuk mund t'i
3 quash fajtorë. Për mua ata janë çlirimtarë, vazhdojnë me qenë
4 çlirimtarë dhe ky është perceptimi im.
5 PY. Prezumimi i pafajësisë është parim i shenjtë që e zbaton
6 edhe kjo Gjykatë edhe çdo gjykatë tjetër Penale. Por ju keni
7 thënë këtu që "kjo është padrejtësi", ju keni thënë -
8 padrejtësi - që të gjykohen "ata që kanë bërë luftë të drejtë
9 dhe luftë çlirimtare".

10 Ju jeni deputete, ju e dini çfarë funksioni ka një
11 gjykatë. Gjykata pikërisht kërkon të vërtetojë nëse një person
12 është apo nuk është përgjegjës penal për një vepër të caktuar.
13 Pra, ju gjykoni që është e padrejtë që të ngrihen mekanizmat,
14 të gjitha këto mekanizma që janë ngritur për t'u zbuluar nëse
15 një person ka kryer një krim, përfshirë këtu edhe anëtarët e
16 UÇK-së? A është kjo pikëpamja juaj?

17 PË. Ne nuk e kemi pasë të dhënat dhe akuzat që janë ba ndaj
18 ish-krerëve të UÇK-së. E kam thënë se ka, ndoshta, fakte të
19 fabrikua. Unë s'kam lidhje se kush janë këta dëshmitarë dhe
20 për cilën drejtësi po thirrreni. Mendimi im personal është se
21 është formuar një gjykatë një nacionale dhe pikërisht kjo ka
22 qenë arsyeja që unë si deputete e Kuvendit të Kosovës nuk e
23 kam votuar ligjin për Dhomat e Specializuara.

24 PY. Po, prapë nuk më dhatë një përgjigje. Nëse ka viktimë ose
25 qoftë edhe persona që thonë jemi viktimë e një krimi --

Dëshmitarja: W04444 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis (Vazhdim)
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

Faqe 9

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Prokuror, do t'i jap fjalën Avokatit.

3 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

4 Nuk mendoj që kolegu im i nderuar, duhet ta keqkuptojë
5 idenë e dëshmitares. Ideja është shumë e qartë dhe ajo po
6 thotë jo. Ideja është e ndërlikuar në vetvete dhe për të marrë
7 fjalët individualisht, se po të marrësh vetëm fjalë të
8 caktuara të një ideje je gati -- del me përfundime të tjera.

9 Kështu që më mirë, ta pyesë dëshmitaren të komentojë për
10 idenë në këtë paragraf dhe të mos marrë vetëm dy-tre fjalë nga
11 gjithë paragrafi edhe të shtrembërojë të gjithë kuptimin e
12 paragrafit. Kjo është përshtypja ime. Faleminderit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dy
14 komente në lidhje me këtë. Fillimisht Prokurori mund të
15 vazhdojë me këtë linjë pyetjesh. Dhe në këtë sallë gjyqi, unë
16 e shoh që ju jeni përpjekur të përdorni një shprehje të
17 caktuar, po ne në këtë sallë gjyqi, nuk varim njeri ne. Ne
18 përpiqemi të zbulojmë prova me aq sa kemi mundësi.

19 Vazhdoni, Prokuror.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

21 PY. Znj. Kadriaj, fokusohemi dhe një herë. A mendoni ju që
22 është padrejtësi që persona të caktuar, viktima krimesh, bëhet
23 një hetim, disa persona mendojnë që "janë viktima të një krimi
24 të caktuar" edhe disa persona janë identifikuar si kryes të
25 mundshëm të këtyre krimeve. Pra, ju mendoni që është

1 padrejtësi të lind, të çelet një proces për të vërtetuar
2 përgjegjësinë penale të një personi bazuar në pretendimet e
3 viktimave? Ju besoni se ky proces është i padrejtë këtë keni
4 dashe të thoni me deklaratën tuaj?

5 Pyetja ime është precize, është e saktë, ju keni thënë
6 është padrejtësi të gjykosh personat. Nuk keni thënë t'i
7 shpallësh fajtor pa prova. Nuk ka akoma shpallje të fajësisë
8 apo të pafajësisë. Por t'i gjykosh këta persona. A është ky
9 qëndrimi juaj?

10 PË. Është Gjykata ajo që vendos a janë të fajshëm apo të
11 pafajshëm. Dhe nëse e shihni paragrafin e fundit e kam thënë
12 se Kosova i ka dhënë përkrahje Gjykatës. Dhe mendimi imi ka
13 qenë se besoj në pafajësinë e ushtarëve të UÇK-së sepse
14 gjithmonë i janë përgjigjur thirrjeve që i janë bërë. S'ka
15 ushtar i UÇK-së që u ka bërë një thirrje me ju përgjigj kësaj
16 Gjykate dhe që nuk ju ka përgjigj kësaj thirrje.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
18 Dëshmitare, ju lutem përgjigjuni pyetjes se ju e dini, siç e
19 dimë dhe ne, që nuk po i përgjigjeni pyetjes. Mbase pyetja
20 mund të jetë e vështirë, por ama ju nuk po i përgjigjeni.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

22 PY. Po apo jo, pra, edhe njëherë, a e konsideroni ju
23 padrejtësi të fillosh një gjykim për të vërtetuar nëse
24 pretendimet e viktimave janë të vërteta apo jo? A mendoni ju
25 se kjo është e padrejtë, po apo jo?

Dëshmitarja: W04444 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 11

Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis (Vazhdim)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 PË. Po kam mëndu --

2 PY. Vetëm kaq. A qëndroni kësaj deklaratë apo jo?

3 PË. Jo, të lutem, është dashtë me e komentu. Unë mendoj që
4 është padrejtësi dhe e kam cekë në paragrafin e fundit sepse e
5 kemi pa që ka fakte ose janë fakte të fabrikuara dhe të blera
6 nga regjimi i Serbisë për t'i akuzuar krerët e Ushtrisë
7 Çlirimtare të Kosovës.

8 PY. A jeni në dijeni ju se ka pasur disa gjykime, nuk po i
9 përmend të gjitha, po disa, ku Gjykata ka konstatuar se ish-
10 anëtarë të UÇK-së kanë qenë përgjegjës për krime të rënda
11 kundër shqiptarëve të Kosovës dhe flas për gjykimin kundër
12 Sabit Gecit, Xhemshit Krasniqit, Latif Gashit, Harajdin Balaj
13 në TPNJ në gjykimin ku u përfshi dhe z. Limaj -- dhe Ajeti, më
14 falni. A e dini ju -- në gjykimin e z. Limaj dhe Izet Musliu
15 të cilët u shfajësuan. A jeni në dijeni ju që këta të tjerët
16 janë shpallur fajtorë? Pra, e dini ju që pretendimet e këtyre
17 viktimave në këto gjykime që përmenda rezultuan se ishin të
18 vërteta?

19 PË. I kam përcjellë jo në detaje, për shkak se për shkak të
20 angazhimeve ditore, angazhimeve që kam punë nuk kam mujt me i
21 përcjellë, jo, as këto seancat as ato seancat, por megjithatë
22 kur është dhënë një vendim nga Gjykata, unë mendoj që e kanë
23 aprovuar të gjithë dhe e kam përkrahë. Ata njerëz nëse kanë
24 kry krime i kanë mbajtur dënimet, ju kanë shqiptuar dënimet, ju
25 kanë mbajtur, domethënë, ju kanë përgjigj drejtësisë.

Dëshmitarja: W04444 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 12

Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis (Vazhdim)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 PY. Pra, ndonëse ka pasur gjykime edhe pretendime të
2 shqiptarëve të Kosovës, ishin legjitime dhe ish-anëtarë të
3 UÇK-së u shpallën fajtorë, ju mendoni se është e padrejtë që
4 të bësh një gjykim në këtë sallë gjyqi për të vërtetuar nëse
5 pretendimet e viktimave në këtë çështje gjyqësore apo në një
6 çështje gjyqësore janë legjitime apo jo, për ju është e
7 padrejtë kjo?

8 PË. Nëse po aludoni në artikullin që e kam përpara, unë s'kam
9 thënë për ato raste në të cilat është vu drejtësia në vend.
10 Kam fol me rastin e arrestimit të krerëve të Ushtrisë
11 Çlirimtare të Kosovës, të cilët ende janë në proces gjyqësor
12 dhe që nuk ka një vendim final për ta.

13 PY. Këtë gjykim, ju e konsideroni të padrejtë, fakti që ata
14 po gjykohen ju e konsideroni të padrejtë? Po apo jo?

15 PË. E kam thënë nëse është me fakte të fabrikuara dhe me
16 fakte të grumbulluara nga Serbia e konsideroj që është e
17 padrejtë.

18 PY. Ju s'e dini këtë. Po ju nuk e dini këtë. Ka pasë gjykime
19 të tjera ku s'ka pasë fabrikime dhe janë dënuar personat në
20 bazë të dëshmive që ishin të vërteta. Ju thatë që keni qenë e
21 ngarkuar me punën tuaj. Pra, ju nuk e dini a janë apo s'janë
22 fabrikime. A është padrejtësi të gjykos personat, nuk po
23 themi t'i shpallësh fajtorë, po t'i gjykos personat të
24 analizosh provat për të vërtetuar pretendimet e atyre që thonë
25 se janë viktima a është kjo padrejtësi?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: W04444 (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 13

Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis (Vazhdim)

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 PË. Përderisa nuk vërtetohet e kundërta e kam këtë qëndrim.

2 PY. Faleminderit, znj. Kadriaaj.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit, z. Prokuror.

6 Znj. Dëshmitare, tani Mbrojtësi i Viktimave ka disa

7 pyetje për ju.

8 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Mbrojtësi i Viktimave sapo na tha që nuk ka pyetje, po shoh

11 sërish Ekipin e Mbrojtjes nëse ka nevojë përnjë raund të dytë

12 pyetjesh për ju.

13 Z. Gilissen.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo, as ne nuk kemi pyetje.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po

16 konsultohem me kolegët e mi tani dhe do t'ju them për një

17 moment.

18 [Anëtarët e Trupit Gjykes këshillohen]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

20 Dëshmitare, as Trupi Gjykes nuk ka pyetje për ju. Që do të

21 thotë që këtu përfundojmë me dëshminë tuaj. Ju faleminderit

22 për dëshminë që dhatë këtu dhe edhe sot dhe për përpjekjet

23 tuaja në dëshminë tuaj. Faleminderit.

24 Ju uroj rrugë të mbarë. Dhe ju rikujtoj se nuk duhet të

25 diskutoni dëshminë tuaj me askënd. Tani Asistentja e sallës së

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 gjyqit do t'ju shoqëroj jashtë.

2 [Dëshmitarja largohet]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Sekretare e Gjykatës, a mund të kalojmë në seancë private.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

[Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F793*

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam

20 edhe një urdhër gojor për të dhënë që ka të bëjë me

21 Dëshmitarin 4280 është një prej dëshmitarëve që do të dëgjojmë

22 javën e ardhshme.

23 Më 16 nëntor, në orën 2.30 informuam Panelin se

24 Dëshmitari 4280 do të dëshmonte në javën e datë 27 nëntor deri

25 më 1 dhjetor përmes videolidhjes. Dhe e kemi regjistruar këtë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F793

Faqe 15

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 korrespondencë me numrin 137 dhe duhet t'ju shpjegojmë arsyet
2 sepse kemi vendosur të veprojmë kështu.

3 Ne vendimin tonë e bazojmë në 428/RED, paragrafi 12-14,
4 që është korniza ligjore e zbatueshme. Kemi konstatuar
5 vlerësimin e Zyrës Administrative dhe rekomandimet [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR] I referohemi parashtrimin të
11 protokolluar 721 lidhur me këtë.

12 Ne jemi të bindur si Trup Gjykses, se teknologjia në
13 dispozicion e bën të mundur që dëshmitari të merret në pyetje
14 në të njëjtat kushte, siç do të merrej në sallën e gjyqit dhe
15 se dëshmia përmes videolidhjes nuk do të shkaktojë dëm apo të
16 jetë në mospërputhje me të drejtat e të akuzuarit. Për
17 rrjedhojë, kemi vendosur të dëgjojmë këtë dëshmitar përmes
18 videolidhjes nga i njëjti vend siç ishte vendosur më parë që
19 bën të mundur dhënien e një dëshmie të vërtetë dhe të hapur.

20 Urdhërojmë Zyrën administrative që të bëjë angazhimet e
21 nevojshme për Dëshmitarin 4280 për të dhënë dëshmi përmes
22 videolidhjes.

23 Me këtë përfundojmë vendimin tonë gojor.

24 Mund të kthehemi në seancë publike.

25 ~~{Seancë e hapur}~~

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F793.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Javën
2 e ardhshme do të japim një pasqyrë të përgjithshme të urdhrave
3 gojorë që do japim dhe hapat procedurat e nevojshme lidhur me
4 këtë pikë.

5 Për më tej, në qoftë se palët kanë diçka për të ngritur
6 mund ta ngrenë tani. Ka ndonjë gjë nga palët?

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo.

8 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

9 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Atëherë do të ndërpresim seancën deri të hënën në orën 9.30.
12 Do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Mbrojtjes 403.

13 Dhe falënderoj përkthyesit, stenografin, shërbimin e
14 sigurisë, kabinën audiovizuale dhe të gjitha palët e
15 pranishme.

16 --- Seanca mbyllet në orën 10.03

17

18

19

20

21

22

23

24

25